

EC
MA NDËRYSHE



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

HULUMTIM

PRIZRENI

“QYTET MUZE” PA MUZE?



PËRMBAJTJA

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e EC Ma Ndryshe dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, apo KCSF-së.

Botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren

Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, 10000/Prishtinë

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

029-222-771 & 038-224-967

Autor i hulumtimit: Enes Toska

Asistentë të hulumtimit: Ilirjana Çollaku, Fati Çeku dhe Eroll Shabani

Lekturimi: Ardian Muçaj

Falënderojmë për kontributin: Valon Xhabali

Hyrje **3**

Qëllimi i hulumtimit dhe metodologjia **3**

Muzetë, definicioni dhe tipet **5**

Vlerat institucionale të muzeut **6**

Muzetë në kontekst ndërkombëtar **6**

Muzetë në kontekst rajonal **9**

Muzetë në kontekst vendor **11**

Hartëzimi i muzeve të qytetit **14**

Hulumtimi i muzeve të qytetit të Prizrenit **15**

Konkulzione e rekomandime **33**

Indeksi i fotografive **35**

Referencat institucionale dhe bibliografike **35**

Maj, 2018

Hyrje

Muzeu është institucion që kujdeset për koleksion të artefakteve dhe objekteve të tjera me rëndësi artistike, kulturore, historike ose shkencore. Këto artefakte, muzetë i vënë në dispozicion të publikut përmes ekspozitave që mund të jenë të përhershme ose të përkohshme.¹

Muzetë më të mëdhenjë gjenden në qytetet e mëdha në gjithë botën, ndërsa mijëra muze lokale ekzistojnë në qytete, qyteza dhe zona rurale më të vogla.

Muzetë kanë qëllime të ndryshme, duke filluar nga shërbimi për studiues e specialistë e deri tek shërbimi i publikut të gjerë. Qëllimi i shërbimit të studiuesve gjithnjë e më shumë po zhvendoset me atë të shërbimit për publik të gjerë.

Që nga vitet 2010, përshpejtimi i vazhdueshëm i digjitalizimit të informacionit, e kombinuar me rritjen e kapacitetit të ruajtjes së këtyre informacioneve, po shkakton që modeli tradicional i muzeve të zgjerohet në përfshirje të ekspozitave virtuale multimediale dhe një qasje më kreative të edukimit të publikut.

Qyteti i Prizrenit, krahas epitetit të kryeqytetit kulturor të Kosovës, sipas perceptimit të përgjithshëm të publikut kosovar është qytet me vlera të lashta kulturore dhe historike dhe mban edhe epitetin e "Qytetit muze".

Ky epitet domosdoshmërisht reflekton ruajtjen e strukturës së saj historike dhe rrjedhimisht nënkupton edhe promovimin e kësaj pasurie tek publiku i gjërë. Një nga mjetet e promovimit të kësaj pasurie të Prizrenit janë edhe muzetë që mes tjerash kanë po këtë mision.

Mirëpo a e meriton një epitet të tillë sot Prizreni? Sa muze sot gjenden në Prizren dhe sa prej tyre janë funksionale e të hapura për publik? Në çfarë gjendje janë dhe çfarë ofrojnë muzetë e këtij qyteti? Sa reflektohet

diversiteti kulturor i këtij qyteti në muzetë e saj?

Hulumtimi "Prizreni, "qytet muze" pa muze?" tenton të jep përgjigje në këto dhe shumë pyetje sa i përket këtyre çështjeve dhe adreson problemet që duhet të zgjidhen në këtë fushë.

Qëllimi i hulumtimit dhe metodologjia

Qyteti i Prizrenit është i njohur që nga antikiteti, si një vend unik në Ballkan, për vlerat e trashëgimisë kulturore, të civilizimeve dhe religjioneve të ndryshme. Falë pozitës së favorshme gjeografike, gërshetimit harmonik të këtyre kulturave gjatë historisë dhe një numri të lakmueshëm të monumenteve të të gjitha kohërave, qyteti i Prizrenit me plot të drejtë mban epitetin e "qytetit muze", "muzeut nën qiellin e hapur" apo edhe të "Dubrovnikut të Ballkanit", për t'u radhitur si njëri ndër qytetet më të bukura të Kosovës.²

I vendosur rrëzë maleve të Sharrit, (që janë shpallur "park nacional"), në të dy brigjet e Lumbardhit dhe në kryqëzimin e rrugëve të rëndësishme tregtare mes lindjes dhe perëndimit, qyteti i Prizrenit, gjatë historisë ishte i njohur si qendër e rëndësishme kulturore, ekonomike e diplomatike.³

Epiteti i "Qytetit Muze" domosdoshmërisht reflekton ruajtjen e strukturës historike të qytetit dhe rrjedhimisht nënkupton edhe promovimin e kësaj pasurie tek publiku i gjërë. Edhe Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+ tek rajoni jugor ku përfshihen Komuna e Prizrenit, e Suharekës dhe e Dragashit (të cilat në aspekt hapësinor ky Plan i koncepton si Kopshte të Kosovës) tek vizioni dhe qëllimet e përgjithshme përmend që Prizreni duhet të shpallet dhe të promovohet si "Qytet muze".

Duke e ditur se qyteti i Prizrenit është një nga qytetet më të vizituara në Kosovë, një nga mjetet e promovimit të kësaj pasurie të Prizrenit janë edhe muzetë që mes tjerash

¹Edward Porter Alexander, Mary Alexander; Alexander, Mary; Alexander, Edward Porter (September 2007). *Museums in motion: an introduction to the history and functions of museums*. Rowman & Littlefield, 2008. ISBN 978-0-7591-0509-6. Retrieved 6 October 2009.

²Komuna e Prizrenit "Prizreni, vendtakimicivilizimeve", 2012

³Po aty

kanë po këtë mision. Mirëpo a e meriton një epitete të tillë sot Prizreni? Sa muze sot gjenden në Prizren dhe sa prej tyre janë funksionale e të hapura për publik? Në çfarë gjendje janë dhe çfarë ofrojnë muzetë e këtij qyteti? Sa reflektohet diversiteti kulturor i këtij qyteti në muzetë e saj?

Qëllimi kryesor i hulumtimit është reflektimi sa i më i saktë i gjendjes ekzistuese të gjithsej gjashtë muzeve të qytetit të Prizrenit dhe adresimi i çështjeve që kanë të bëjnë me funksionimin e tyre. Muzetë e hulumtuar janë:

1. Muzeu i Kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit



2. Muzeu arkeologjik - Hamami i Shemsidin beut dhe Sahatkulla



3. Muzeu etnologjik - Shtëpia e shehzades



4. Muzeu i hapur arkeologjik



5. Muzeu i elektroekonomisë - Hidroelektrana "Prizrenasja"



6. Muzeu i Nënë Terezës



Metodologjia e punës e kryer pjesërisht gjatë vitit 2017 dhe fillim të vitit 2018 ka konsistuar në: hulumtimin e dokumenteve zyrtare, hulumtimin e literaturës, takime e intervista të drejtpërdrejta me zyrtarë të muzeve që janë hulumtuar si dhe vizitat dhe fotodokumentimi në terren në mënyrë që të arrihet një analizë sa më e plotë e gjendjes ekzistuese.

Hulumtimi përmbillet me konkluzione dhe rekomandime që i adresohen Ministrisë së Kulturës, Komunës së Prizrenit dhe menaxhmentit të muzeve të qytetit.

Muzetë, definicioni dhe tipet

Definicioni dhe emërtimi

Definicioni i muzeut ka evoluar, në përputhje me zhvillimet në shoqëri. Që nga krijimi i saj në 1946, ICOM (The International Council of Museums - Këshilli Ndërkombëtar i Muzeve) e përditëson këtë përkufizim në përputhje me realitetet e komunitetit global të muzeve.



Sipas Statutit të ICOM, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e 22-të në Vjenë (Austri) më 24 gusht 2007: "Muzeu është institucion jo fitimprurës dhe i përhershëm në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, i hapur për publik, i cili siguron, konzervon, hulumton, komunikon dhe ekspozon trashëgiminë e prejkshme dhe të paprekshme të njerëzimit dhe të mjedisit të saj për qëllime të edukimit, studimit dhe kënaqësisë." Ky përkufizim është një referencë në bashkësinë ndërkombëtare.

Emërtimi "Muze" është me origjinë nga greqishtja e lashtë *Mouseion* që nënkupton një vend ose tempull kushtuar Muses (hyjnitë mbrojtëse të arteve në mitologjinë greke), si dhe një ndërtesë e veçantë për studim dhe art.⁴

Tipet e muzeve

Në botë ekzistojnë shumë lloje të muzeve, duke përfshirë muzetë e artit, muzetë e historisë natyrore, muzetë shkencore, muzetë e luftës, muzetë e fëmijëve, etj. Ndër muzetë më të mëdha dhe më të vizituara në botë janë:

- Muzeu i Luvrit në Paris (8.600.000 vizitorë në vit),

- Muzeu Kombëtar i Kinës në Pekin (7.290.000 vizitorë),
- Institucioni Smithsonian-Muzeu Kombëtar i Hapësirës në Uashington DC (7.000.000 vizitorë),
- Muzeu Britanik (6.820.686 vizitorë) dhe Galeria Kombëtare në Londër (5.908.254 vizitorë),
- Muzeu Metropolitan i Artit në Nju Jork (6.533.106 vizitorë),
- Muzetë e Vatikanit në Vatikan (6.002.251 vizitorë).⁵

Tipologjitë e muzeve variojnë nga institucione të mëdha, që mbulojnë shumë nga kategoritë e mëposhtme, deri tek institucione shumë të vogla që fokusohen në një subjekt të veçantë, vendngjarje ose një person të rëndësishëm.

Tipet kryesore të muzeve përfshijnë:

- Muzetë arkitekturore;
- Muzetë arkeologjike;
- Muzetë e artit;
- Muzetë biografike;
- Muzetë e automobilave;
- Muzetë e fëmijëve;
- Muzetë e dizajnit;
- Muzetë enciklopedike;
- Muzetë etnologjike / etnografike;
- Muzetë e shtëpive historike;
- Muzetë e historisë;
- Muzetë e historisë së vazhdueshme (ambiente të rikrijuara historike ku jeton komuniteti);
- Muzetë detare;
- Muzetë mjekësore;
- Muzetë përkujtimore / memoriale;
- Muzetë ushtarake dhe të luftës;
- Muzetë mobile (lëvizëse);
- Muzetë e historisë natyrore;
- Muzetë në ambient të hapur;
- Muzetë pop-up (afatshkurta);
- Muzetë e shkencës;
- Muzetë e specializuara;
- Muzetë virtuale;
- Parqet zoologjike; dhe

⁴Findlen, Paula (1989). "The Museum: its classical etymology and renaissance genealogy". *Journal of the History of Collections*. 1 (1): 59–78. doi:10.1093/jhc/1.1.59. (2008)

⁵Twenty most visited museums in 2015 compiled by AECOM and the Themed Entertainment Association's annual report on the world's most visited attractions.

- Kopshtet botanike.

Brenda këtyre kategorive, shumë muze specializohen më tej, p.sh.: në muze të artit modern, të artit popullor, të historisë lokale, historisë ushtarake, historisë së aviacionit, filatelistë, bujqësisë, gjeologjisë, etj.

Ndonjëherë mund të jetë e dobishme të bëhet dallimi midis muzeve diakronike dhe sinkronike. Sipas profesorit Eric Kilgerman të Universitetit të Floridës, "Përderisa një muze në të cilin një tregim i veçantë shpaloset brenda sallave të ekspozimit të saj është diakronik, ato muze që kufizojnë hapësirën e tyre një përvojë të vetme quhen sinkronike."⁶

Vlerat institucionale të muzeut

Muzetë me aktivitetet dhe përmbajtjet e tyre bartin në vete pesë vlera të rëndësishme⁷:

1. Vlera e koleksionit: paraqet thelbin e ekzistencës së një muzeu dhe përfshin një gamë të gjërë vlerash që lidhen me grumbullimin, ruajtjen, menaxhimin dhe aktivitetet ekspozuese;

2. Vlera e lidhjes dhe e rrjetëzimit: varet nga aftësia e muzeut për të vepruar si pjesë e një rrjeti dhe ndërmjetësues midis grupeve të ndryshme të shoqërisë (duke i dhënë konsistencë temave aktuale dhe çështjeve përmes konteksteve relevante dhe kuptimplota) duke u bërë një platformë ideale për komunikim, debate dhe lidhjen e partneritetit me palët e ndryshme të interesit;

3. Vlera edukative: qëndron në aftësinë e muzeut për të pozicionuar veten si një mjedis edukativ dhe arsimor (formal dhe joformal) për grupe të ndryshme të shoqërisë. Muzetë mund të shërbejnë si shkolla edhe në kuptimin e mirëfilltë: për të rinjtë për të plotësuar njohuritë e tyre dhe angazhim në punë praktike; për të rriturit që duan të praktikojnë interesat dhe hobit e tyre; për akademikët që të kryejnë hulumtime të specializuara;

4. Vlera e përvojës: lidhet me kapacitetin e muzeut për të ofruar mundësi për kënaqësi, përvojë dhe aventurë; vend për

frymëzim, relaksim dhe gjithashtu veprim, ku njerëzit mund të stimulohen si fizikisht, ashtu edhe intelektualisht;

5. Vlera ekonomike: varet nga kontributi i muzeut në ekonominë e një vendi: numri i turistëve që tërheqin muzetë, vendet e punës direkte apo indirekte që ato krijojnë, kapitali njerëzor i përfaqësuar nga stafi dhe vullnetarët, aftësia tërheqëse e muzeve ndaj bizneseve dhe familjeve me nivelet e larta të arsimit, dhe efektet e shumëfishta mbi të ardhurat lokale.

Muzetë në kontekst ndërkombëtar



Këshilli Ndërkombëtar i Muzeve (ICOM)

Këshilli Ndërkombëtar i Muzeve (ICOM) është organizatë ndërkombëtare e krijuar në vitin 1946 nga dhe për profesionistët e muzeve. ICOM punon për shoqërinë dhe zhvillimin e saj dhe është e angazhuar për të garantuar ruajtjen, vazhdimin dhe mbrojtjen e të mirave kulturore.

ICOM ka pesë misione kryesore: vendosja e standardeve të përsosmërisë, udhëheqja e një forumi diplomatik, zhvillimi i rrjetit profesional, udhëheqja e një *think-tank*'u global dhe misionet ndërkombëtare.

ICOM nuk është në dijeni rreth numrit të saktë të muzeve në botë. Sidoqoftë, në botimin e saj të 21-të (2014) "Muzetë e Botës", databaza më gjithëpërfshirëse e botuar nga De Gruyter përfshin mbi 55.000 muze në 202 shtete të botës.

ICOM numëron më shumë se 35.000 anëtarë, që përfaqësojnë më shumë se 20.000 muze, nga 136 vende dhe territore. ICOM përbëhet nga rreth 119 Komitete Kombëtare dhe 30 Komitete Ndërkombëtare që përfaqësojnë specializime të ndryshme të muzeve. Pesë Aleancat Rajonale të ICOM ofrojnë një forum për shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimit midis Komiteteve Kombëtare, muzeve dhe punëtorëve profesionistë të muzeut në rajonet e tyre përkatëse. Së fundmi, 21 Organizata Ndërkombëtare të

⁶Kilgerman, Eric. *Sites of the Uncanny: Paul Celan, Specularity and the Visual Arts*, p. 255 (2007).

⁷Netherlands Museums Association "More Than Worth It", Holandë 2011

Specializuara janë të lidhur me ICOM. Ato mbledhin lloje të veçanta të muzeve ose grup muzesh dhe/ose profesionistë të muzeve në një rajon të caktuar.

Dita Ndërkombëtare e Muzeve

Vizita në muze nuk është një praktikë e izoluar kulturore, por pjesë e një skeme më të gjërë të pjesëmarrjes kulturore. Karakteristikat e prapavisë kanë të njëjtin ndikim në vizitat muzeore si në vizitat e objekteve dhe manifestimeve të tjera artistike dhe kulturore.

Niveli arsimor është faktori më i rëndësishëm: njerëzit që kanë arsimim të lartë janë të mbi-përfaqësuar midis vizitorëve të ngjarjeve artistike dhe kulturore. Meqenëse niveli i arsimit është i lidhur fort me të ardhurat dhe standardin e jetesës në shoqërinë bashkëkohore meritokratike, njerëzit me arsim të lartë mund të konsiderohen edhe si elita sociale⁸.



Çdo vit, që nga viti 1977 Dita Ndërkombëtare e Muzeve organizohet në mbarë botën më datë 18 maj. Kjo ditë është një rast për të rritur ndërgjegjësimin rreth asaj se sa muzetë janë të rëndësishme në zhvillimin e shoqërisë.

Komiteti Këshilldhënës i ICOM organizon temën e kësaj ngjarjeje vjetore që, duke marrë parasysh numrin e madh të vendeve të përfshira, zgjat një ditë, fundjavë, javë apo edhe një muaj. Nga Amerika në Oqeani, përfshirë Afrikën, Evropën dhe Azinë, kjo ngjarje ndërkombëtare ka konfirmuar popullaritetin e saj.

Këto vite të fundit, Dita Ndërkombëtare e Muzeve po përjeton rritjen më të lartë me pothuajse 30.000 muze që organizuan

aktivitete në më shumë se 120 vende të botës.

Tema e çdo viti të Ditës Ndërkombëtare të Muzeve (DNM) dallon varësisht zhvillimeve globale apo trendeve në fushën e zhvillimit të muzeve.

Shembull, tema e Ditës Ndërkombëtare të Muzeve në vitin 2017 ishte: *Muzetë dhe historitë e kontestuar: tregimi i storieve të pathëna (tabu) në muze*. Kjo temë fokusohet në rolin e muzeve që, duke punuar për të përfutur shoqërinë, bëhet qendër për nxitjen e marrëdhënieve paqësore mes njerëzve. Ajo gjithashtu thekson se si pranimi i një tregimi të kontestuar është hapi i parë në parashikimin e një të ardhmeje të përbashkët nën flamurin e pajtimit. Duke zgjedhur për të treguar të pathënat (tabutë) në muze, tema e DNM 2017 tentonte të elaboronte aspektet e pakuptueshme të historive të kontestuar të qenësishme në racën njerëzore. Këtë vit, gjithashtu u inkurajua që muzetë të luajnë një rol aktiv në adresimin në mënyrë paqësore të historive traumatike përmes ndërmjetësimit dhe pikëpamjeve të shumfishta.



⁸Vladimír Bína "Museum participation in six European countries", 2012

Muzetë në relacion me lokalitetet e trashëgimisë kulturore

Muzetë dhe lokalitetet e trashëgimisë janë elemente të rëndësishme të peizazhit tonë kulturor. Ato dokumentojnë se kush kemi qenë, kush jemi tani dhe na tregojnë për atë që mund të bëhemi në të ardhmen. Muzetë e bëjnë këtë duke prezantuar dëshmi materiale se si kemi ndryshuar me kalimin e kohës, sikurse makineritë, veshjet, veprat e artit, etj. Ndërtesat e trashëgimisë janë edhe hapësira në të cilat ndodh ndryshimi kulturor. Ato gjithashtu janë dëshmi materiale për ndryshimet teknologjike, shoqërore dhe shpirtërore përmes mënyrës si ato janë ndërtuar, mënyrën se si janë vendosur hapësirat e tyre dhe njerëzit që i kanë përdorur ato. Ne kemi nevojë për muze dhe ndërtesa të trashëgimisë për të na kujtuar se jemi pjesë e një vazhdimësie kulturore dhe se kemi përgjegjësi për pasardhësit tanë në mënyrë që të transmetojmë dhe të ruajmë njohuritë tona për të kaluarën dhe të tashmen.

Shumica e muzeve sot janë të vendosura në ndërtesat e trashëgimisë kulturore. Në shumicën e rasteve kjo ka qenë një model i suksesshëm që e vë ndërtesën në përdorim të duhur dhe thekson rëndësinë e koleksionit. Në raste të rralla, ato paraqiten si modele të pasuksesshme pasi që nuk përfiton as ndërtesa e trashëgimisë e as koleksioni. Vetëm për shkak se një ndërtesë është e vjetër, nuk do të thotë që ajo medoemos duhet të konvertohet në muze⁹.

Kur një ndërtesë konsiderohet vend i trashëgimisë, ndërtesa dhe përmbajtja e saj konvertohen vetvetiu në muze. Koleksioni është zakonisht i mbyllur, duke kërkuar adaptime minimale për hapësirën për qëllime ekspozimi. Sfidë kryesore e këtyre muzeve shpesh sillet rreth asaj se si të lëvizin njerëzit përmes ekspozitës në mënyrë që të sigurojnë infrastrukturën për të vizituar muzeun pa e dëmtuar integritetin e saj.

Për muzetë dhe galeritë që ekspozojnë materiale që nuk lidhen drejtpërdrejt me ndërtesën e trashëgimisë dhe përdorimin e saj, sfida është t'i ipet vizitorit një kuptim të

historisë së vendit, duke ofruar edhe hapësirë për ekspozita.

Në këtë mes, vend të rëndësishëm zë edhe shfrytëzimi kreativ i monumenteve të trashëgimisë për funksione muzeale. Në vijim do të prezantohen dy shembuj interesantë të një shfrytëzimi të tillë:

Muzeu i Tycho Brahe, Suedi



Tycho Brahe ishte një fisnik, astronom dhe shkrimtar danez i njohur për vëzhgimet astronomike dhe planetare të sakta dhe gjithëpërfshirëse. Ai ka lindur në gadishullin e atëhershëm Danez të Scania që sot gjendet në territorin e shtetit Suedez.



Muzeu i Tycho Brahe gjendet në vendin e kompleksit të astronomëve në ishullin Ven, në mes të Oresundit në Suedi. Zona përbëhet nga ekspozita në ish-Kishën e Gjithë Shenjtorëve, Observatori Stjerneborg,

⁹NSW Heritage Office: *Just because it's old: museums and galleries in heritage buildings*, 2004


Kopshti i Rilindjes i rikrijuar, Parku i Fëmijëve "Idetë e Historisë" dhe një gjurmë e orbitës së planetit e bërë në shkallë reale. Mbetjet e kalasë dhe observatori i Brahe-s janë monumente të mbrojtura në zonë. Muzeu përfshin gjithashtu një dyqan suvenirësh dhe kafe. Muzeu mahnit me ekspozitën e punimeve të astronomit Brahe të vendosur sidomos në kishë, por edhe në lokacionet tjera ku ka jetuar dhe vepruar.¹⁰



Muzeu Kombëtar i Kinemasë, Itali



Ikona arkitektonike e qytetit të Torinos, Mole Antonelliana, fillimisht u ndërtua për sinagogë, përpara se të blihej nga Bashkia e Torinos dhe të shëndrrohej në një monument të unitetit kombëtar. Projektuar nga arkitekti Alessandro Antonelli në 1863, u përfundua vetëm në 1889. Me një lartësi prej 167.5 metra, ishte ndërtesa më e lartë me tulla në Evropë në atë kohë. Ngjitja panoramike u përfundua në vitin 1961, gjatë kremtimeve për 100 vjetorin e Unifikimit të Italisë dhe u rinovua në vitin 1999. Sot vizitorët ende lejohen të ngjiten në tarracë panoramike e cila është 85 metra e lartë dhe të mrekullon me pamje të mahnitshme të qytetit dhe alpeve përreth.



Ky monument, sot funksionon si Muze Kombëtar i Kinemasë dhe përmban koleksion të kinematografisë italiane dhe asaj botërore. Ky "tempull i kinemasë" përmes rampave spirale ngjitet përmes disa niveleve të ekspozitës, duke krijuar një shfaqje spektakolare të koleksioneve të saja të jashtëzakonshme dhe duke rikthyer historinë e kinemasë nga origjina e saj deri në kohën e tashme, një itinerar interesant ndërveprues.¹¹

Muzetë në kontekst rajonal

Muzetë janë institucione të fuqishme që përfaqësojnë dhe reflektojnë shoqërinë. Ato mbledhin, ruajnë, hulumtojnë dhe na edukojnë për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen tonë. Në një mënyrë ato mund të shihen si një "kujtesë kolektive". Kjo do të thotë se muzetë nuk janë neutrale; ato vendosin se çfarë ka rëndësi dhe çfarë nuk ka. Ata gjykojnë vlerësime nëpërmjet asaj që shfaqin dhe mënyrës se si e shfaqin.

Shumë njerëz e pranojnë se muzetë mund të kontribuojnë në demokraci dhe përmbushje të drejtave të njeriut. Ato mund të jenë vende ku diskutohen çështje të vështira dhe ku mund të ndodhë debati. Ato mund të jenë

¹⁰www.tripadvisor.com

¹¹<http://www.museocinema.it>

gjithashtu vende ku njerëzit mund të takohen dhe të përjetohet trashëgimia e përbashkët. Megjithatë, kjo nuk është gjithmonë realiteti pasi muzetë shpesh janë manipuluar dhe përdoren si armë politike duke paraqitur pamje të njëanshme të shoqërisë.

Historia e shekujve të fundit të Ballkanit Perëndimor është ajo e konflikteve, luftërave dhe diktaturave politike. Megjithatë, ky rajon posedon edhe një fond të gjërë të trashëgimisë së përbashkët që mund të zbulojë një pamje shumë të ndryshme nga ajo që njihet; ka diversitet të pasur, arritje njerëzore, qytetërime të lashta dhe art bashkëkohor të avancuar. Muzetë gjithashtu mund ta paraqesin këtë fytyrë në botë dhe të bëhen vende të krijimtarisë, zgjidhjes së konfliktit dhe dialogut.

Për të mbështetur këtë proces, Fondacioni suedez Trashëgimia Kulturore pa Kufij themeloi Rrjetin e Muzeve të Ballkanit në vitin 2006, të mbështetur financiarisht kryesisht nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida).

Rrjeti i Muzeve të Ballkanit (Balkan Museum Network) ekziston për të festuar, ruajtur dhe ndarë trashëgiminë e përbashkët komplekse të Ballkanit dhe për të krijuar, nëpërmjet bashkëpunimit, një zë të fortë kolektiv për trashëgiminë ballkanike dhe profesionin e muzeut.

Misioni i BMN është ndryshimi i muzeve në Ballkan duke:

- mbështetur zhvillimin e udhëheqësve kreativ të muzeve;
- avokuar muzetë e përgjegjshme shoqërore që promovojnë dhe festojnë edukimin dhe mësimin; dhe
- bashkëpunuar në avancimin e parimeve të paqes dhe pajtimit duke përdorur trashëgiminë e përbashkët të Ballkanit si trampolinë të saj për brezat e tanishme dhe të ardhshme.



Qëllimet dhe objektivat e BMN fokusohen në:

- Forcimin e muzeve dhe profesioneve të trashëgimisë në Ballkan përmes ndërtimit të kapaciteteve;
- Shëndrrimin e muzeve në vlera dhe përdorimin e tyre si burim dhe aktor në shoqërinë civile; dhe
- Krijimin e platformës së fortë për bashkëpunim dhe avokim kolektiv për muzetë si institucione dhe njerëzit që punojnë në to.

Ky rrjet i muzeve sot numëron mbi 60 anëtarë përfshirë këtu muzetë dhe organizatat joqeveritare nga rajoni. Nga Kosova anëtare janë: Muzeu i Kosovës, Muzeu i Mitrovicës, Muzeu Etnografik i Pejës dhe Muzeu Regjional i Gjakovës.

Aktivitetet kryesore të rrjetit përfshijnë gjithpërfshirjen në aktivitetet e përditshme të muzeve, përkrahjen e grave dhe vajzave në sektorin muzeor, interpretimin e koleksioneve, grante të vogla për muzetë e rajonit dhe konferenca vjetore me tematika që mbahen në lokacione të ndryshme, sikurse ajo e vitit 2017 që është mbajtur në Prishtinë.

Muzeu i Kosovës ka qenë një nga përfituesit kryesor të këtij rrjeti i cili edhe ka zbatuar shumë aktivitete kreative të cilat janë ndërtuar përmes këtij rrjetëzimi insitucional.



Muzetë në kontekst vendor

Në Kosovë nuk ka statistika të publikuara se sa muze ekzistojnë, sa prej tyre janë publike apo private, çfarë koleksioni posedojnë, sa është numri i vizitorëve apo dhe të ardhurat që gjenerohen nga këto institucione.

Një çështje tjetër problematike në këtë fushë është mungesa e legjislacionit. Hartimi i një ligji të veçantë për muzetë në vend është përfolur qysh vite më parë, por kjo mundësi vazhdon të mbetet peng i miratimit dhe neglizhencës së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Ky ligj do të rregullonte fushëveprimtarinë e muzeve në vend, do të ndikonte dukshëm në avancimin dhe rregullimin e muzeve në mbarë vendin, posaçërisht raportet mes muzeve dhe shumë aspekte të tjera, duke përfshirë dhe mundësinë e themelimit të muzeve të natyrave të ndryshme përfshirë edhe mekanizmat menaxhues të tyre.

Miratimi i infrastrukturës ligjore është poashtu një nga kriteret kryesore të "Strategjisë Kombëtare për trashëgimi kulturore 2017-27" të hartuar nga po i njëjti institucion (MKRS) dhe aty përfshihet avancimi i legjislacionit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë. Masat e përfshira në strategji adresojnë: 1. Definimin e statusit të institucioneve të trashëgimisë kulturore dhe themelimin e institucioneve të reja (Muzeut Arkeologjik, Muzeut Etnologjik, dhe Muzeut të Historisë së Natyrës.), 2. Përmirësimin e kapaciteteve profesionale të punonjësve të trashëgimisë kulturore dhe 3. Programet trajnuese për ciceronë dhe kuratorë muzeal, menaxherë, laborantë dhe profesionistë të tjerë të fushës.

Edhe pse me sfida të mëdha në shumë drejtime, kjo nuk do të thotë që muzetë nuk ekzistojë fare, përkundrazi Kosova ka muze relativisht të mira për kontekstin e vet kulturor dhe fuqinë ekonomike që posedon.

Një nga institucionet kryesore në këtë lëmi padyshim është **Muzeu i Kosovës**. Ai është themeluar në vitin 1949, ndërkaq ndërtesa me arkitekturë Austro-hungareze daton që nga viti 1885/6. Muzeu ka për qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe prezantimin e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës.



Muzeu i Kosovës përfshin një koleksion, me më shumë se 50 mijë eksponate të profileve të ndryshme, prej pavijonit të arkeologjisë, teknologjisë, historisë, natyrës, entokulturës, folklorit, trashëgimisë etj. Aktualisht, muzeu është duke u angazhuar në rikthimin e 1200 objekteve/artefakteve të rëndësishme për trashëgiminë kulturore të Kosovës, të marra nga Beogradi gjatë vitit 1998.

Në vazhden e aktiviteteve të 10-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, gjatë shkurtit të vitit 2018 Muzeu i Kosovës ka inauguruar "Ekspozitën Bazë", e para e konceptuar si e këtitillë që përmban eksponate të periudhave të ndryshme të trashëgimisë kulturore nga periudha e Neolitit e deri te Shpallja e Pavarësisë së Kosovës më 2008.



Eksponate të rralla dhe të rëndësishme të veçantë janë prezantuar në këtë ekspozitë si: Medaljoni i Probit, Sarkofagu i Dresnikut, kopja e Vrapueses së Prizrenit, Monumenti Votiv i Perëndeshës Dardane nga Smira, pastaj eksponate të heronjve kombëtar Isa Boletini e Adem Jashari po ashtu janë prezantuar dhe janë të hapura për t'i parë qytetarët. Ndër to edhe xhaketa e William Walker që ka pasur veshur gjatë luftës së Kosovës dhe gjësendet personale të ish-sekretares amerikane Madeleine Albright.


Këto artefakte, si pjesë të trashëgimisë së luajtshme kulturore të Kosovës pasqyrojnë identitetin kulturor dhe historik të vendit tonë.

Ndër muzetë tjera më të spikatura në Kosovë mund të veçohen edhe këto:

Kompleksi memorial i familjes Jashari. Janë bërë njëzet vjet nga rënia heroike e familjes Jashari dhe për këto vite, Kompleksi Memorial "Adem Jashari", ka pritur më shumë se 12 milionë vizitorë. Numri i vizitorëve, sipas ciceronëve të kompleksit, ka shkuar duke u rritur. Kullat e familjes Jashari, janë ndër vendet për të cilat vizitorët tregojnë më shumë interesim të dinë, për vet faktin se kanë mbetur të njëjtat që nga beteja e lavdishme e 5, 6 dhe 7 marsit 1998. Kohëve të fundit këto kulla kanë nisur të dëmtohen në mungesë të konservimit.¹²



Kompleks banimi "Emin Gjiku" - Muzeu Etnologjik i vendosur në "zemër" të Prishtinës së vjetër në zonën e ish-tregut oriental (çarshisë), ka qenë një pjesë përfaqësuese e koleksionit etnologjik të Muzeut të Kosovës prej vitit 2006. Koncepti i ekspozitës së titulluar "Cikli i jetës" nga kuratorët e saj, ndjek dizajnin e brendshëm të ndërtesës kryesore të kompleksit, një shtëpi dykatëshe në pronësi të Emin Gjikut, një tregtar nga Prishtina e shekullit XIX. Ideja lëvizëse pas dizajnit të ekspozitës së muzeut ishte prezantimi i objekteve nga koleksioni i pasur etnografik i Muzeut të Kosovës, të mbledhur nga i gjithë territori që pasqyrojnë jetën socio-ekonomike të popullsisë në shekujt XIX dhe XX. Sipas Trip Advisor (sajti më i madh botëror i udhëtimeve), ky muze ka qenë atraksioni kryesor i vizituar në Kosovë gjatë vitit 2016.



Muzeu i Pejës, i vendosur në Konakun e Tahir Beut, prezenton trashëgiminë kulturore të Rajonit të Pejës. Posedon rreth 700 eksponate etnologjike, prej të cilave 450 janë të ekspozuara në ekspozitën 'Trashëgimia Kulturore e Rajonit të Pejës', dhe 100 artefakte arkeologjike të ekspozuara në ekspozitën 'Trashëgimia Kulturore Arkeologjike'. Kjo pasuri tregon traditën dhe kulturën e begatë të trevës së Dukagjinit dhe numrin e madh të zejeve që kanë vepruar në këtë regjion.¹³



Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve Trepça në Stantërg të Mitrovës është e njohur me bukuri të kristaleve e mineraleve të llojeve të ndryshme. Duke pasur parasysh këtë fakt në vitin 1964 themelohet Muzeu i kristaleve të mineraleve në të cilin janë të vendosura mbi 1300 eksponate të llojeve të ndryshme të kristaleve duke e shndërruar Muzeun në një objekt me rëndësi të madhe kombëtare për Kosovën si në aspekt të vlerave po ashtu edhe në aspekt turistik. Përveç kristaleve në Muze janë të ekspozuara edhe mjete të vjetra pune me të

¹²Gazeta Zëri: Kompleksi memorial 'Adem Jashari', vendi më i vizituar në Kosovë, qasur më 26 04 2018

¹³<http://www.pejatourism.org>, qasur më 26 04 2018

cilat janë shërbyer xehetarët në fillimet e punimeve në minierë.¹⁴



Kompleksi Monumental i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit është poashtu një nga muzetë më të vizituara në vendin tonë duke e bartur rëndësinë historike që ka ajo për të gjithë shqiptarët kudo që jetojnë dhe veprojnë. Ky hulumtim paraqet të dhëna më detaje në lidhje me këtë muze të cilat mund t'i shihni në faqet në vijim.

Muzeu i Muzikës në Gjakovë, i pari i këtij lloji në Kosovë dhe i vendosur në monumentin e tabhanes përmban libra, dorëshkrime, fotografi, instrumente, partitura, disqe etj. të cilat pasqyrojnë traditën dhe vlerat e të gjitha gjinive muzikore ndër vite të qytetit të Gjakovës, atyre që janë me origjinë dhe që e bartën këtë traditë kudo që jetuan dhe vepruan.¹⁵



Muzeu i lidhjeve të thyera (Museum of Broken Relationships Kosovo) i dedikohet mbledhjes, ruajtjes dhe shfaqjes së objekteve të dhuruara nga njerëzit në mbarë botën pas

¹⁴ Ministria e Mjedisit dhe planifikimit hapësor / Agjencioni për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës / instituti i Kosovës për mbrojtjen e natyrës: "Raporti për gjendjen e natyrës në Kosovë 2010-14"


¹⁵ Facebook: Visit Gjakova

shpërbërjes së lidhjeve të tyre. Kjo ekspozitë e veçantë udhëtuese me origjinë nga kryeqyteti kroat, Zagreb, është hapur në Prishtinë nga 3 maj deri më 1 qershor dhe i dedikohet tregimeve të dëshpëruara, për të shpjeguar të gjitha marrëdhëniet, çfarë ka ndodhur jo vetëm mes të dashuruarve, por edhe midis miqve dhe familjeve.

Për këtë ekspozitë, në Kosovë përmes thirrjes publike janë grumbulluar 30 objekte. Një kontribues nga qyteti i Prizrenit shkruan në një kavanoz kujtimi: "Ky kavanoz mban ditët dhe netët e bukura të marrëdhënies sonë dhe kjo nuk meriton të hidhet e të mos kujtohet."

Me përfundim të ekspozitës në Kosovë, disa nga objektet do të dërgohen në muzeun e përhershëm në Zagreb, ku në këtë mënyrë, tregimet nga Kosova do të jenë pjesë e përhershme të një muzeu ndërkombëtar.

Ky muze ka fituar çmimin EMYA Kenneth Hudson në vitin 2010 për projektin më inovativ dhe më të guximshëm në Evropë.¹⁶



Hulumtimi i muzeve të qytetit të Prizrenit

Në vijim, gjeni të bashkangjitur hartën dhe tabelat përshkruese me të gjitha informatat relevante për të gjitha muzetë e qytetit të Prizrenit.

¹⁶ <https://www.voanews.com/a/museum-of-broken-relationships-comes-to-kosovo/4385343.html> lqasurmë 9 Maj 2018





KOMPLEKSI I LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT

	INFORMATA TË PËRGJITHSHME
Kategoria	Muze historik
Pronar	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Menaxhues	Qendra rajonale për trashëgimi kulturore - Prizren
Statusi ligjor	Monument nën mbrojtje të përkohshme
Orari	08:00 – 19:00 prej të martës deri të dielën. Të hënën pushim, përderisa punohet edhe gjatë festave zyrtare.
Viti i themelimit	1968 dhe 1978
Stafi i angazhuar	5
Biletat dhe çmimi	1 € për person, 0.20 € për nxënës. Pa pagesë për invalidë, familjarë të dëshmorëve dhe veteranë të luftës.
	INFORMATA MBI VIZITORËT
Numri i vizitorëve	45.000-55.000 vizitorë në vit
Grupmosha më e shpeshtë e vizitorëve	Fëmijë (0 - 14) Të rinjë (15 – 24) √ Të rritur (25 – 59) Të moshuar (60+)
Profili më i shpeshtë shoqëror i vizitorëve	Individuale Çift √ Familjar √ Grupe të organizuara nxënësish / studentësh Grupe të organizuara vizitorësh / turistësh
Profili më i shpeshtë kombëtar i vizitorëve	√ Vendas Ndërkombëtar
Motivi fillestar i shprehur për vizitë në muze	Vizita e vendngjarjes kryesore në historinë e popullit shqiptar dhe vlerat e kompleksit monumental
	INFORMATA MBI KOLEKSIONIN DHE SHËRBIMET
Përshkrimi i koleksionit	Lidhja Shqiptare e Prizrenit e mbajtur në vitin 1878 përbën ngjarjen më të rëndësishme deri atëherë të Rilindjes Kombëtare dhe një nga ngjarjet më madhore në historinë e popullit shqiptar. Në vitet 1976/78 bëhen ndërhyrje të rëndësishme duke rrënuar disa objekte të kompleksit të Gazi Mehmed Pashës për të formuar Muzeun e Lidhjes së Prizrenit për nder të 100 vjetorit të

	saj. Gjatë luftës së fundit në vitin 1999 digjet tërësisht ndërtesa e rezidencës së Lidhjes e cila rindërtohet në qershor të vitit 2000. Tani Muzeu i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit përbëhet nga tri sektorë: 1. Ndërtesa e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ku gjendet Sektori Historik me tematikën historike të Lidhjes, ku janë të paraqitura dokumentet e shkruara, armë të vjetra dhe pamje të figurave historike e politike të Lidhjes së Prizrenit. Ndërtesa e medresesë ku në përdhësë gjendet 2. Sektori Etnografik, me veshje karakteristike nga trojet e banuara nga shqiptarët; dhe 3. Në katin e medresesë gjendet Galeria e Arteve me piktura me tematikë të kushtuar ngjarjes dhe personaliteteve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.
Panelet interpretuese të koleksionit të muzeut	Katërgjuhësore (Shqipe, Angleze, Gjermane dhe Franceze tek paneli hyrës në muze) Tek eksponatet: gjuha shqipe, te një pjesë edhe anglisht
Informatat publike kontaktuese për vizitë në muze (orari i vizitave dhe telefoni)	Tabela informative në hyrje të muzeut Webfaqe Facebook ✓ Nuk ka
Shërbimet që ofrohen	Vizitë individuale (pa përcjellje) ✓ Vizitë me përcjellje të ciceronit (<i>në gjuhë angleze marte-shtune nga ora 10 deri 17, në gjuhë shqipe prej orës 08 deri 19 marte-diele</i>) Audio-guidë ✓ Dyqan për suvenirë / dhurata / libra Parking për vizitorë
Qasja gjithpërfshirëse	Parking për persona me aftësi të kufizuara Rampa e përshtatshme në hyrje të muzeut Qasja e papenguar (pa pragje) në brendi të muzeut WC për persona me aftësi të kufizuara Interpretimi i koleksionit në alfabet Braille për të verbër Shenjëzimi i përshtatshëm për persona pjesërisht të verbër ✓ Nuk ka
Sfidat kryesore që duhet ti adresojë muzeu sipas stafit?	Ngritja e kapaciteteve njerëzore / profesionale ✓ Prodhimi i broshurave informative / edukative ✓ Krijimi i webfaqes së muzeut Promovimi më i madh i muzeut, përfshi mediat sociale Aplikimi i hyrjes me biletë Dyqan për suvenirë / dhurata / libra







HAMAMI I SHEMSIDIN BEUT DHE SAHATKULLA

	INFORMATA TË PËRGJITHSHME
Kategoria	Muze arkeologjik
Pronar	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Menaxhues	Qendra rajonale për trashëgimi kulturore - Prizren
Statusi ligjor	Monument nën mbrojtje të përkohshme
Orari	08:00 – 16:00 çdo ditë pune
Viti i themelimit	1975
Stafi i angazhuar	1
Biletat dhe çmimi	1 € për person, 0.50 € për grupe të organizuara
	INFORMATA MBI VIZITORËT
Numri i vizitorëve	Nuk ka statistika 20 vizitorë (mars 2018). Gjatë sezonit veror rritet numri i vizitorëve
Grupmosha më e shpeshtë e vizitorëve	Fëmijë (0 - 14) Të rinjë (15 – 24) ☒ Të rritur (25 – 59) Të moshuar (60+)
Profili më i shpeshtë shoqëror i vizitorëve	☒ Individuale ☒ Çift ☒ Familjar ☒ Grupe të organizuara nxënësish / studentësh ☒ Grupe të organizuara vizitorësh / turistësh
Profili më i shpeshtë kombëtar i vizitorëve	Vendas ☒ Ndërkombëtar
Motivi fillestar i shprehur për vizitë në muze	Kureshtja për sahatkullën
	INFORMATA MBI KOLEKSIONIN DHE SHËRBIMET
Përshkrimi i koleksionit	Muzeu prezanton materialin arkeologjik nga lokalitete arkeologjike të regjionit të Prizrenit, gjegjësisht nga komuna e Prizrenit, Dragashit, Rahovecit dhe Suharekës. Materiali i prezantuar ka një diapazon kronologjik të gjerë që nga neoliti i hershëm, eneoliti, periudha e bronzit, periudha e hekurit, periudha romake, mesjeta e hershme dhe mesjeta e vonë.

Panelet interpretuese të koleksionit të muzeut	Trigjuhësore (Shqipe, angleze dhe serbe në tabelën hyrëse të muzeut) Trigjuhësore (Shqipe, Serbe dhe Turke në tiketat shënuese të eksponateve)
Informatat publike kontaktuese për vizitë në muze (orari i vizitave dhe telefoni)	Tabela informative në hyrje të muzeut Webfaqe Facebook √ Nuk ka
Shërbimet që ofrohen	√ Vizitë individuale (pa përcjellje) √ Vizitë me përcjellje të ciceronit Audio-guidë √ Dyqan për suvenirë / dhurata / libra Parking për vizitorë
Qasja gjithpërfshirëse	Parking për persona me aftësi të kufizuara Rampa e përshtatshme në hyrje të muzeut Qasja e papenguar (pa pragje) në brendi të muzeut WC për persona me aftësi të kufizuara Interpretimi i koleksionit në alfabet Braille për të verbër Shenjëzimi i përshtatshëm për persona pjesërisht të verbër √ Nuk ka
Sfidat kryesore që duhet ti adresojë muzeu sipas stafit?	√ Ngritja e kapaciteteve njerëzore / profesionale √ Prodhimi i broshurave informative / edukative √ Krijimi i webfaqes së muzeut √ Promovimi më i madh i muzeut, përfshi mediat sociale Aplikimi i hyrjes me biletë √ Dyqan për suvenirë / dhurata / libra







SHTËPIA E SHEHZADES

	INFORMATA TË PËRGJITHSHME
Kategoria	Muze etnologjik/etnografik
Pronar	Komuna e Prizrenit
Menaxhues	Shoqata Numizmatike Shqiptare "Demastion"
Statusi ligjor	Monument nën mbrojtje të përkohshme
Orari	09:00 – 16:00 çdo ditë pune
Viti i themelimit	2013
Stafi i angazhuar	7
Biletat dhe çmimi	1 € për person, 0.50 € për nxënës, 0.30€ për grupe të organizuara
	INFORMATA MBI VIZITORËT
Numri i vizitorëve	Nuk ka statistika
Grupmosha më e shpeshtë e vizitorëve	☒ Fëmijë (0 - 14) ☒ Të rinjë (15 – 24) ☒ Të rritur (25 – 59) ☒ Të moshuar (60+)
Profili më i shpeshtë shoqëror i vizitorëve	Individuale ☒ Çift ☒ Familjar ☒ Grupe të organizuara nxënësish / studentësh ☒ Grupe të organizuara vizitorësh / turistësh
Profili më i shpeshtë kombëtar i vizitorëve	☒ Vendas ☒ Ndërkombëtar
Motivi fillestar i shprehur për vizitë në muze	Referenca nga miqtë dhe arsytet tjera personale
	INFORMATA MBI KOLEKSIONIN DHE SHËRBIMET
Përshkrimi i koleksionit	Muzeu prezanton koleksionin etnologjik të veshjeve të ndryshme tradicionale dhe eksponateve numizmatike të shqiptarëve të Prizrenit dhe komunitetit goran të regjionit të Opojës.
Panelet interpretuese të koleksionit të muzeut	Katër-gjuhësore (Shqipe, Serbe, Turke dhe Angleze)

Informatat publike kontaktuese për vizitë në muze (orari i vizitave dhe telefoni)	Tabela informative në hyrje të muzeut Webfaqe ✓ Facebook Nuk ka
Shërbimet që ofrohen	Vizitë individuale (pa përcjellje) ✓ Vizitë me përcjellje të ciceronit Audio-guidë ✓ Dyqan për suvenirë / dhurata / libra Parking për vizitorë
Qasja gjithpërfshirëse	Parking për persona me aftësi të kufizuara Rampa e përshtatshme në hyrje të muzeut Qasja e papenguar (pa pragje) në brendi të muzeut WC për persona me aftësi të kufizuara Interpretimi i koleksionit në alfabet Braille për të verbër Shenjëzimi i përshtatshëm për persona pjesërisht të verbër ✓ Nuk ka
Sfidat kryesore që duhet ti adresojë muzeu sipas stafit?	Ngritja e kapaciteteve njerëzore / profesionale ✓ Prodhimi i broshurave informative / edukative Krijimi i webfaqes së muzeut Promovimi më i madh i muzeut, përfshi mediat sociale Aplikimi i hyrjes me biletë Dyqan për suvenirë / dhurata / libra







MUZEU I HAPUR ARKEOLOGJIK

	INFORMATA TË PËRGJITHSHME
Kategoria	Muze i hapur
Pronar	Komuna e Prizrenit
Menaxhues	Drejtoria për turizëm dhe zhvillim ekonomik
Statusi ligjor	Pronë / hapësirë publike
Orari	Nuk aplikohet
Viti i themelimit	2012
Stafi i angazhuar	Nuk ka
Biletat dhe çmimi	Nuk aplikohet
	INFORMATA MBI VIZITORËT
Numri i vizitorëve	Nuk ka informata
Grupmosha më e shpeshtë e vizitorëve	Fëmijë (0 - 14) Të rinjë (15 – 24) Të rritur (25 – 59) Të moshuar (60+) √ Nuk ka informata
Profili më i shpeshtë shoqëror i vizitorëve	Individuale Çift Familjar Grupe të organizuara nxënësish / studentësh Grupe të organizuara vizitorësh / turistësh √ Nuk ka informata
Profili më i shpeshtë kombëtar i vizitorëve	Vendas Ndërkombëtar √ Nuk ka informata
Motivi fillestar i shprehur për vizitë në muze	Muzeu shumë pak njihet dhe vizitohet nga qytetarët shkaku i pozitës jo të favorshme. Lokacioni i muzeut më së shumti frekuentohet gjatë verës kur funksionalizohet kafeneja e hapur.
	INFORMATA MBI KOLEKSIONIN DHE SHËRBIMET
Përshkrimi i koleksionit	Muzeu i hapur prezanton koleksionin e kopjeve të artefakteve nga vendbanimet arkeologjike të regjionit të Prizrenit (Vlashnje, Korishë, Poslisht, Reshtan, Kalaja e Prizrenit, etj). Artefaktet janë kopjuar në mënyrë identike nga origjinali dhe datojnë që nga

	epoka e Neolitit e deri tek periudha e Antikitetit të Vonë. Koleksioni, fatkeqësisht nuk është në gjendje të mire sepse ka thyerje të xhamave dhe të ndriçimit të instaluar.
Panelet interpretuese të koleksionit të muzeut	Vetëm në gjuhë shqipe
Informatat publike kontaktuese për vizitë në muze (orari i vizitave dhe telefoni)	Tabela informative në hyrje të muzeut Webfaqe Facebook √ Nuk ka
Shërbimet që ofrohen	√ Vizitë individuale (pa përcjellje) Vizitë me përcjellje të ciceronit Audio-guidë Dyqan për suvenirë / dhurata / libra Parking për vizitorë
Qasja gjithpërfshirëse	Parking për persona me aftësi të kufizuara Rampa e përshtatshme në hyrje të muzeut Qasja e papenguar (pa pragje) në brendi të muzeut WC për persona me aftësi të kufizuara Interpretimi i koleksionit në alfabet Braille për të verbër Shenjëzimi i përshtatshëm për persona pjesërisht të verbër √ Nuk ka
Sfidat kryesore që duhet ti adresojë muzeu?	Ngritja e kapaciteteve njerëzore / profesionale √ Prodhimi i broshurave informative / edukative Krijimi i webfaqes së muzeut √ Promovimi më i madh i muzeut, përfshi mediat sociale Aplikimi i hyrjes me biletë Dyqan për suvenirë / dhurata / libra





HIDROELEKTRANA - MUZEU I ELEKTROEKONOMISË




Hidroelektrana "Prizrenasja" – Muzeu i Elektroekonomisë që nga viti 2016 është monument nën mbrojtje të përheshme dhe është në pronësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Ky muze gjendet në kilometrin e 3-të të grykës së Lumbardhit dhe është ndërtuar më 1929 buzë lumit. Është centrali i parë elektrik dhe muzeu i vetëm i Elektroekonomisë në Kosovë. Hidroelektrana ka furnizuar qytetin e Prizrenit me rrymë elektrike prej vitit 1929 deri në vitin 1973. Më 8 nëntor 1979 shndërrohet në Muze të Elektroekonomisë së Kosovës, ku u prezantuan shumë materiale origjinale dhe fotografi që pasqyrojnë zhvillimin e elektroekonomisë në Kosovë dhe ka funksionuar si muze vetëm dy vite.

Ky muze është restauruar në sajë të mjeteve të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Projekti i restaurimit është hartuar nga Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore në Prizren dhe organizata Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHWB Kosova). Punët restauruese kanë filluar në vitin 2012, dhe janë përmbyllur në vitin 2013. Planifikimi ka qenë që pas përfundimit të punëve restauruese, objekti të rikthehet në funksionin e Muzeut të Energjisë Elektrike, ndërkohë që brenda tij është rregulluar edhe një punëtori studimi.

Muzeu i Elektroekonomisë deri më tani rrallë herë ka hapur dyert për aktivitete, derisa as që bëhet fjalë për funksionim të përditshëm.



MUZEU I NËNË TEREZËS



Ky muze i painauguruar dhe jofunksional gjendet përballë Katedrales së Zonjës Ndhimtare në Qendrën Historike të Qytetit. Është ndërtesë e re, por destinimi i menduar do t'i jepte një rëndësi të veçantë këtij objekti. Muzeu kushtuar Nënës Terezë padyshim do të ishte një pjesë shumë e rëndësishme e mozaikut kulturor të Prizrenit.

Ndërtesa është në pronësi të Komunës së Prizrenit dhe punimet kanë zgjatur nga 2010 deri në 2012 dhe është financuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Në mes të vitit 2015 është dhënë edhe drita e gjelbërpër pranimin teknik të objektit, por megjithëkëtë Muzeu sote kësaj dite i ka të mbyllura dyert.

Gjendja fizike e saj duket se është në rregull. Ka prezencë të lagështisë, pasi ndërtesa është e mbyllur dhe nuk ka qarkullim të ajrit. Pasi muzeu nuk është në funksion dhe është i mbyllur, nuk dihet nëse ndërkohë diçka nga instalimet nuk janë në rregull.



Konkluzione e rekomandime

Muzetë kanë një rol të veçantë në shoqëri, atë të mbështetjes së ndryshimeve pozitive shoqërore, duke siguruar një copë jete nga e kaluara, e tashmja, madje edhe parashikime për të ardhmen. Ato konkretisht paraqesin çka vlerëson një komunitet specifik në lidhje me trashëgiminë e tyre dhe atë që ata do të donin t'i trashëgonin gjeneratave të ardhshme. Vlera e tyre edukative është e pamohueshme, duke kontribuar në jetën bashkëkohore të komuniteteve, në jetë shoqërore dhe ekonomike.

Në bazë të të dhënave të prezantuara në këtë hulumtim, muzetë e qyteti të Prizrenit nuk i plotësojnë në tërësi standardet ndërkombëtare të aplikueshme. Rrjedhimisht, epiteti "Qytet muze" përfshi këtu humbjen dhe degradimin e viteve të fundit në lokalitetet e trashëgimisë kulturore, duket të jetë i pamërituar.

Dy nga gjithsej gjashtë muzetë e qytetit nuk janë të hapura fare për publikun dhe nuk janë funksionale. Edhe gjendja në katër muzetë tjera të qytetit nuk duket të jetë në nivel të kënaqshëm profesional dhe teknik.

Problemet e përgjithshme që paraqiten në këto katër muze që janë në funksion fillojnë që nga ajo se asnjëra nga to nuk përfaqësohen në asnjë iniciativë ndërkombëtare apo rajonale; nuk e përfaqësojnë denjësisht diversitetin kulturor të qytetit të Prizrenit; nuk kanë shërbime bashkëkohore me të cilat do të ishin atraktive për vizitorë; nuk janë fare gjithpërfshirëse në aspekt të trajtimit të nevojave të audiencës bashkëkohore por edhe të audiencës së personave me aftësi të kufizuara, etj.

Edhe pse muzetë ekzistuese kanë fond të vlefshëm dhe të pasur të koleksionit, prezantimi i tyre në disa raste nuk bëhet në mënyrë adekuate, sikurse pluhuri në ekspozate, xhamat e vitrinat e dëmtuara, veshjet tradicionale të gozhdura në mure, etj.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme për nga pesha, në muzetë e qytetit vërehet mungesë e madhe e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale.

Në vijim gjendet një listë me rekomandime të adresuara në tri nivele të ndryshme se si të trajtohen problematikat dhe sfidat e paraqitura në muzetë e qyteti të Prizrenit:

Ministritë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

- Të adpotohet sa më parë ligji që rregullon themelimin dhe funksionimin e muzeve nëpër komuna të Kosovës
- Të adoptohet udhëzimi administrativ për Komuna ku definohen tipologjitë e muzeve dhe kërkesat ligjore që duhet të përmbushen për themelim dhe funksionim të tyre
- Të tejkalohet koncepti i muzeve etnologjike/etnografike duke u përkrahur konceptet e reja të muzeve që kanë interaksion / komunikim më të lartë me publikun
- Të krijohet një databazë e të dhënave dhe statistikave të vizitorëve të muzeve që menaxhohen nga ky institucion përfshi edhe të hyrat që gjenerojnë ato
- Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve profesionale të stafit të muzeve që menaxhohen nga ky institucion
- Muzeu i Lidhjes së Prizrenit dhe Muzeu Arkeologjik të kalojë nën ombrellë të Komunës së Prizrenit për menaxhim sa më efikas. Aktivitetet e muzeve mund të financohen bashkarisht nga MKRS dhe Komuna e Prizrenit
- Konsultim publik dhe gjithpërfshirje në menaxhim të muzeve ekzistuese dhe planifikim të ndërtimit të muzeve të reja
- Hapja dhe funksionalizimi i muzeut të Hidroelektranes
- Hapja dhe funksionalizimi i muzeut të Nënës Terezë
- Hapja dhe funksionalizimi i muzeut të Kalasë së Prizrenit

Komunës së Prizrenit

- Të krijohet një databazë e të dhënave dhe statistikave të vizitorëve të muzeve që menaxhohen nga ky institucion përfshirë edhe të hyrat që gjenerojnë ato
- Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve profesionale të stafit të muzeve që menaxhohen nga ky institucion
- Konsultim publik dhe gjithpërfshirje në menaxhim të muzeve ekzistuese dhe planifikim të ndërtimit të muzeve të reja
- Monumentet e qytetit që nuk kanë funksion të adaptohen në muze me tematike kreative në mënyrë që të parandalohet degradimi dhe mosshfrytëzimi i tyre
- Të themelohet Muzeu i Qytetit të Prizrenit ku do të prezantohej historia dhe zhvillimi urban i qytetit, shtresimet kulturore përgjatë historisë ku do të bëhej edhe prezantimi i diveristetit kulturor të qytetit. Muzeu do të duhej të përfshinte edhe pjesën e personaliteteve të rëndësishme të qytetit përgjatë historisë, apo të trajtohet edhe si muze në vete
- Të themelohet Muzeu për aktorin e njohur Bekim Fehmiun

Muzeve të qytetit të Prizrenit

- Të krijohet një sistem menaxhimi efikas i sistemit të stafit profesional dhe teknik
- Të pasurohet fondi ekzistues i muzeve që menaxhohet duke bërë interpretim bashkëkohor të koleksionit në të gjitha gjuhët zyrtare lokale dhe atë angleze si dhe përfshirja e audio guidave, video projeksioneve, ekpozitave virtuale, etj
- Të ndërrohet orari i punës së muzeve nga ditët e zakonshme të punës. Gjatë fundjavës qyteti ka vizitorë më të shumtë dhe rrjedhimisht edhe muzetë duhet të jenë të hapura
- Orari publik, bashkë me kohën e vizitës, çmimin e biletave, telefonin dhe webfaqen duhet të vendosen në tabelën hyrëse të muzeut
- Ofrimi i biletave të përbashkëta ku vizitorët me një biletë të çmimit më të volitshëm do të mund të vizitojnë disa apo të gjitha muzetë e qytetit

- Muzetë e qytetit të riadaptohen në mënyrë që të shfrytëzohen për aktivitete të ndryshme, sikurse konferenca, seminare, punëtori. Në këtë mënyrë do të krijoheshin edhe të ardhura shtesë për qëndrueshmërinë e muzeve
- Të planifikohen programe të veçanta edukative dhe interaktive për nxënës dhe studentë në mënyrë që të jenë sa më atraktive për ti vizituar, p.sh. krijimi i këndeve të veçanta me kopje të artefakteve që mund të preken, përpunohen dhe të vizatohen
- Të eliminohen barrierat fizike në muze dhe të adaptohen për përdorim edhe për persona me aftësi të kufizuara, p.sh. rampa e përshtatshme në hyrje të muzeut, qasja e papenguar (pa pragje) në brendi të muzeut, WC për persona me aftësi të kufizuara, interpretimi i koleksionit në alfabet Braille për të verbër, shenjëzimi i përshtatshëm për persona pjesërisht të verbër, etj
- Të planifikohen programe të veçanta edukative dhe interaktive për persona me aftësi të kufizuara në mënyrë që të jenë sa më atraktive për ti vizituar
- Në mënyrë që të krijohet vetëqëndrueshmëria financiare duhet të aplikojnë forma të ndryshme të biznesit në mënyrë që të mos jenë të varur plotësisht nga fondet publike (këndi i kafes/çajit/pijeve, dyqan suvenirësh, librari, etj). Në këtë mënyrë do të krijoheshin edhe vende të reja të punës
- Të dizajnohen publikime të veçanta për koleksionin ekzistues të muzeve
- Të krijohen web faqet për muzetë përfshirë edhe vizitat virtuale
- Të shtohen kanale të ndryshme të komunikimit në faqet e mediave sociale duke e marrë parasysh shfrytëzueshmërinë e lartë të tyre, sidomos mes të rinjve

Indeksi i fotografive

Të gjitha fotografitë e këtij hulumtimi janë pronë e EC Ma Ndryshe përpos këtyre të poshtëcekura:

Ballina: Enterieri i Muzeut arkeologjik - Hamami i Shemsidin beut dhe Sahatkulla (autor: Kujtesa Godeni)

Faqe 1, 11 (sipër), 15, 19 (poshtë), 23 (sipër), 31: Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës

Faqe 5, 7: The International Council of Museum (ICOM)

Faqe 9 (majtas poshtë): www.marcopolo.tv, (djathtas): www.cinebazar.it

Faqe 10: Balkan Museum Network (BMN)

Faqe 11 (poshtë): Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Faqe 12 (majtas): www.ademjashari.rks-gov.net, (djathtas sipër): www.tripadvisor.com, (djathtas poshtë): <https://pejatourism.org>

Faqe 13 (sipër): Facebook-Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve Trepça, (poshtë): Facebook-Visit Gjakova, (djathtas): Facebook-Museum of Broken Relationships Kosovo

Faqe 17: Bleron Çaka

Faqe 18 (në mes): Shkelzen Rexha

Referencat institucionale dhe bibliografike

André Desvallées, François Mairesse "Key Concepts of Museology", 2010

Balkan Museum Network

BE/KE-Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë "Muzeu Etnografik:Emin Gjiku - Ekspozitë Cikli i Jetës", Prishtinë 2014

Databaza e trashëgimisë kulturore të Kosovës

EC Ma Ndryshe "Milionat e shpenzuara për monumentet e mbyllura", Prizren 2016

Europa Nostra CHCfE Consortium project coordinator, "Cultural Heritage Counts for Europe" full report, Krakow 2015

ICOM "Running a museum: A practical Handbook", Paris 2004

Michèle Taylor "Udhëzues mbi aftësitë e kufizuara për muzetë", 2008

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

MKRS "Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2017-2027", Prishtinë 2016

MMPH-IPH "Plani Hapësinor i Kosovës-Strategjia e zhvillimit hapësinor 2010-2020+", Prishtinë 2010

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore Prizren

Stephan Doempke, Anduela Lulo (Caca) dhe Sadi Petrela (eds.) "Katër qytete historike në Ballkanin jugperëndimor", Tiranë 2012

Strategjia Kombëtare për trashëgimi kulturore 2017-27

The International Council of Museum (ICOM)

Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

